



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranimi/Stampimi Me Datë 03.04.2025			
Nr. i Komandës/Çelës	Nr. i Komandës/Çelës	Nr. i Komandës/Çelës	Vlera/Vlerësimi
02	035/02	251	

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 13, 17 paragrafi 17.1 pika e të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 lidhur me nenin 5 paragrafi 3 pika 3.2 të Ligjit për Mbrojtjen e mjedisit Nr. 03/L-025, neni 51.1 të Statutit të Komunës së Vitisë Nr. 01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës me datë 03.04.2025 merr këtë:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E VITIT 2025 VITIN E MBROJTJES SË MJEDISIT DHE MBROJTJES SË PYEJEVE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË VITISË

- I. Ky vendim rregullon sistemin e integruar për mbrojtjen e mjedisit, zvogëlimin e rrezikut për ndotjen e mjedisit, jetën dhe shëndetin e njeriut sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm.
- II. Vlerat e mbrojtura të mjedisit përdoren dhe avancohen në mënyrën e cila e mundëson mbrojtjen dhe avancimin e tyre afatgjatë, në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e mjedisit.
- III. Shfrytëzimi dhe mbrojtja e mjedisit bëhet përmes planifikimit për ruajtjen e cilësisë dhe llojllojshmërisë së tyre, në përputhje me kushtet dhe masat për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara me këtë ligj dhe ligjet e veçanta.
- IV. Komuna e Vitisë angazhohet për zvogëlim gradual të ndotjes, degradimit dhe dëmtimit mjedisor si dhe ndalimin e aktiviteteve ekonomike të cilat gjenerojnë rrezik në shkatërrimin e biodiversitetit natyror, dhe paraqesin rrezik për shëndetin e njerëzve dhe të mjedisit.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Vitisë dhe Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit
2. DUPMM
3. Zyres Ligjore
4. Arkivit

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË

Sokol Haliti

